

Dyzet e një grupe rebele siriane lëshuan një deklaratë ditën e djeshme, duke e dënuar "aleancën ruso-iraniene që po pushton Sirinë".

Ato kanë bërë thirrje për unitet dhe janë betuar t'i sulmojnë forcat ruse në Siri. Rebelët kanë kërkuar nga shtetet e rajonit që të formojnë një aleancë kundër forcave ruse dhe iraniene që po luftojnë në mbështetje të regjimit të Esadit.

Rusia i nisi javën e shkuar bombardimet mbi Siri, me justifikimin se po godet ISIS-in, por sulmet e saj ajrore kanë sjellë shqetësim të gjithmbarshëm, ndërsa opozita siriane e sheh këtë si një ndërmarrje për të dobësuar kundërshtarët e pushtetit aktual në Siri.

Mes 41 grupeve që kanë nënshkruar deklaratën nuk është përfshirë Fronti Nusra, i shmangur për arsye se autoritetet ruse dhe siriane po e përdorin atë si shfajësim për të luftuar opozitën dhe për të vrarë civilët.

Pretendohet ndërkaq se shumica e sulmeve të Rosisë kanë patur si objektiv rebelët antiqeveritarë që po përparojnë drejt Latakias, një qytet i kontrolluar nga Esadi, e që është njëkohësisht një pikë e rëndësishme strategjike për rusët.

Veç kësaj, një paralajmërim i qartë për Rusinë ka ardhur nga NATO-ja, që e ka cilësuar shkeljen e hapësirës ajrore të Turqisë nga avionët rusë një "rrezik ekstrem," duke i kërkuar Moskës gjithashtu të mos i sulmojë civilët dhe rebelët sirianë.

Në fund të një takimi të jashtëzakonshëm të NATO-s është thënë shprehimisht se, "Protestojmë fuqishëm ndaj këtyre shkeljeve të hapësirës ajrore sovrane turke, dhe i dënojmë këto inkursione dhe shkelje të hapësirës ajrore të NATO-s. Po ashtu vëmë në dukje rrezikun ekstrem të një sjellje të tillë të papërgjegjshme."

Sulmet ajrore ruse në Siri kanë sjellë një tensionim të tejskajshëm të situatës, që nuk dihet ende se ç'fund do të ketë. Ato janë parë si një mbështetje e qartë për Beshar Esadin, edhe pse po kryhen në emër të luftës kundër ISIS-it./tesheshi.com/